INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

## KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
## 17-18 NËNTOR 2021

**NDIKIMI I COVID-19 NË HUMBJET MËSIMORE, PASOJAT NË RRITJEN E PABARAZIVE NË MËSIM DHE SFIDAT E PËRMBUSHJES/KOMPENSIMIT**

## INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE
## 17-18 NOVEMBER 2021

**IMPACT OF COVID-19 ON LEARNING LOSSES, CONSEQUENCES IN INCREASING LEARNING INEQUALITIES AND CHALLENGES OF FULFILLMENT/COMPENSATION**

# LIBRI I ABSTRAKTEVE
# BOOK OF ABSTRACTS

**Prishtinë, 2021**

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

# LIBRI I ABSTRAKTEVE

## Nga konferenca shkencore ndërkombëtare
## 17 dhe 18 nëntor 2021, Prishtinë

## Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit

Prishtinë, 2021

# Konferenca shkencore ndërkombëtare

## Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit

Prishtinë, 2021

# International scientific conference

# Impact of COVID-19 on learning losses, consequences in increasing learning inequalities and fulfillment/compensation challenges

Prishtina, 2021

**Botues/ Publisher:**
Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Për botuesin/ The editor**
Nezir Çoçaj, drejtor

**Korrektues gjuhësor/Language Editor**
Bekim Morina

**Përgatitja teknike/ Technical preparation:**
Skender Mekolli

# Përmbajtja

Hyrje ........ 7

Instituti Pedagogjik i Kosovës: Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/ kompensimit ........ 21

Blerim Saqipi, Blerta Perolli: Sfidat e përgatitjes së mësimdhënësve të rinj gjatë mësimit në distancë: motivimi dhe angazhimi i studentëve ........ 25

Tanja Rupnik Vec, Jasna Rojc: Distance learning during the COVID-19 pandemic and support for schools in overcoming the challenges ........ 29

Cristian Fabbi: Nostalgia for the future: envisioning the post COVID-19 early education ........ 32

Dries Froyen: Pandemic as a lever for change ........ 35

Nuhi Bajqinca: Politikate diversitetit dhe inkludimit, para, gjatë dhe pas periudhës së pandemisë në Suedi ........ 37

Claudia Giudici: The new challenges of education today. the school restarts: which threats and opportunities ........ 42

Osman Buleshkaj: Sistemi arsimor pas pandemisë: roli i udhëheqjes në arsim ........ 44

Arbnesha Mexhuani: Qëndrimet e mësimdhënësve, drejtorëve dhe psikologëve të shkollave të mesme të ulëta për aktivizimin e kamerave nga nxënësit gjatë përdorimit të platformave online në mësim ........ 47

Mevlyde Syla: Perceptimet e prindërve për shqetësimet e fëmijëve të moshës parashkollore gjatë COVID-19 ........ 51

Haxhere Zylfiu: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve me bazë në shkollë ........ 54

Dashurije Shaqiri: Sfidat dhe përkrahja e prindërve ndaj fëmijëve në nivelin fillor të arsimit gjatë COVID-19 ........ 58

Antigona Mehmeti: Gatishmëria e nxënësve të klasës XII për COVID-19 dhe ndikimi në jetën dhe të nxënit e tyre ........ 61

Arbnora Lladrovci: Gatishmëria e mësimdhënësve klasorë për procesin mësimor në distancë në komunën e Prishtinës........ 64

B. Mehmetaj, D. Haxhijaj, Sh. Osmanaj: Përparësitë dhe mangësitë e të mësuarit online gjatë pandemisë COVID-19 në shkollat fillore në Kosovë........ 69

## Hyrje

Pandemia globale COVID-19, mbyllja e shkollave dhe organizimi i mësimit në distancë për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së pandemisë, vazhdimi i organizimit të mësimit në kushte të pandemisë, kanë ndikuar në të gjitha sistemet arsimore, në mënyrë të veçantë në mirëqenien e fëmijëve dhe në rezultatet e tyre në mësime. Konferenca ndërkombëtare shkencore *Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit*, e organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, është një mundësi e mirë që shkencëtaret, hulumtuesit dhe profesionistët arsimorë të paraqesin rezultatet e studimeve/kërkimeve lidhur me aspektet tematike të kësaj konference.

Përmes panelistëve, studiuesve, prezantuesve dhe diskutimeve të hapura në këtë konferencë, synojmë që të kuptojmë për së afërmi se si sistemet arsimore u janë përgjigjur rrethanave të krijuara nga pandemia, çfarë kanë qenë ndikimet e pandemisë në arsim, sfidat dhe qasjet institucionale për tejkalimin e sfidave. Po ashtu, të kuptojmë ndikimet në humbjet mësimore, praktikat institucionale për mbështetjen e nxënësve për zbutjen në masë të mundshme të humbjeve mësimore, dhe për të eliminuar

## Introduction

The global pandemic COVID-19, the schools` closure and the organization of distance learning due to preventive measures against the spread of the pandemic, the continuation of the organization of education in pandemic conditions, have affected all education systems, especially the welfare of children and their learning outcomes. International Scientific Conference” Impact of COVID-19 on Learning Losses, Consequences on Increasing Learning Inequalities and Compensation / Compensation Challenges”, organized by the Kosovo Pedagogical Institute, is a good opportunity for scientists, researchers and educational professionals to present the results of studies / research related to the thematic aspects of this conference.

Through panelists, researchers, presenters and open discussions at this conference, we aim to understand better how education systems have responded to the circumstances created by the pandemic, what have been the impacts of the pandemic on education, challenges and institutional approaches to overcoming challenges. Also, understand the impacts on learning losses, institutional practices to support students to mitigate possible learning losses, and eliminate learning inequalities, but also lessons

pabarazitë në mësim, por edhe mësimet nga pandemia dhe mundësitë për ngritjen e sistemeve arsimore pas pandemisë.

Instituti Pedagogjik i Kosovës, si organizator i kësaj konference, do të paraqesë hulumtimin që ndërlidhet ngushtë me tematikën kryesore të konferencës. Ndërsa, disa nga përvojat e mira të reagimeve të sistemeve arsimore ndaj pandemisë, por edhe sfidat dhe problemet, do të paraqiten nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit në Kosovë, nga Fakulteti i Edukimit, si dhe studiues dhe prezantues nga Kosova, Italia, Sllovenia, Suedia, Zvicra, Flandra dhe rajoni.

Vetëm përmes prezantimit të rezultateve të studimeve, përvojave dhe diskutimeve të hapura për ndikimin e pandemisë në arsim, mund të njohim realitetin e funksionimit të arsimit dhe shkollave gjatë pandemisë, nevojat reale të fëmijëve, prindërve dhe mësimdhënësve. Gjithashtu, mund të orientojmë perspektivën për t'iu përgjigjur sistemet arsimore ndikimeve të pandemisë në arsim, në mënyrë që çdo fëmijë të ketë qasje në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Thekse të veçanta të studimeve, përvojave e prezantimeve për temën e konferencës dhe tematikat e saj, të përmbledhura në abstrakte dhe prezantime të studiuesve dhe folësve të kësaj konference, janë përfshirë në librin e abstrakteve

learned from the pandemic and opportunities for building post-pandemic education systems.

Kosovo Pedagogical Institute, as the organizer of this conference, will present the research that is closely related to the main topic of the conference. While, some of the good experiences of the reaction of the educational systems to the pandemic, but also the challenges and problems, will be presented by representatives of the Ministry of Education in Kosovo, the Faculty of Education, as well as researchers and presenters from Kosovo, Italy, Slovenia, Sweden, Switzerland, Flanders and the region.

Only through the presentation of the study results, experiences and open discussions on the impact of the pandemic on education, we can know the reality of the functioning of education and schools during the pandemic, the real needs of children, parents and teachers. We can also orient the perspective to respond to education systems to the impacts of the pandemic on education, so that every child has access to quality and inclusive education.

Special emphasis of studies, experiences and presentations on the topic of the conference and its topics, summarized in abstracts and presentations of scholars and speakers of this conference, are included in the book of abstracts

të konferencës. Me këtë qasje të trajtimit të problematikave në sektorin e arsimit, me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit arsimor, publikimit dhe prezantimit të rezultateve të studimeve, synojmë të rrisim nivelin e shqyrtimit dhe diskutimit shkencor me përgjegjësi dhe profesionalizëm, shkëmbimin e përvojave e mësimeve për tema të veçanta që kanë ndikim në zhvillimet në arsim.

Nezir Çoçaj, drejtor i IPK-së

of the conference. With this approach to addressing issues in the education sector, with broad participation of the educational community, publication and presentation of study results, we aim to increase the level of scientific review and discussion with responsibility and professionalism, exchange of experiences and lessons on specific topics that have an impact on the education development.

Nezir Çoçaj, director of KPI



**Nezir Çoçaj,**
Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës

Pedagog me specializim shkencor në Kërkime në Edukim. Kontributdhënës në aspekte të ndryshme të arsimit dhe edukimit, nga pozita e këshilltarit të ministrit të Arsimit për arsimin parauniversitar, pastaj edhe si deputet i Parlamentit të Kosovës, në dy legjislatura, dhe njëkohësisht si anëtar i Komisionit Parlamentar të Arsimit. Anëtar në komisione dhe grupe punuese për hartimin e politikave dhe dokumenteve të rëndësishme për arsimin në vend.

**Nezir Çoçaj,** is director of the Kosovo Pedagogical Institute.

Pedagogue with scientific specialization in Research in Education. Contributor in various aspects of education, from the position of advisor to the Minister of Education for pre-university education, then as a member of the Parliament of Kosovo, in two legislatures, and at the same time as a member of the Parliamentary Committee on Education. Member of commissions and working groups for drafting important policies and documents for education in the country.



Haxhere Dervisholli - Zylfiu
Master në Letërsi dhe gjuhë shqipe, Fakulteti i Filologjisë në Prishtinë. Nga viti 2007, hulumtuese për arsim joformal, Sektori për Arsim Profesional dhe Arsim Gjatë Gjithë Jetës. Nga viti 2016, koordinatore nacionale për përfaqësim të IPK-së në Consortium of Institutions for Development and Research in Education in Europe - CIDREE http://www.cidree.org
Udhëheqëse e ekipit editorial dhe ekipit kurator të konferencës.

Master in Albanian Literature and Language, Faculty of Philology in Prishtina (2011);
Since 2007, Researcher for non-formal Education, sector for Vocational Education and Lifelong Learning. Since 2016, she is National Coordinator and KPI Representation in the Consortium of Institutions for Development and Research in Education in Europe - CIDREE http://www.cidree.org
Chairwoman of the Editorial Team and Conference Curator Team



Dr. sc. Linda Grapci-Kotorri
Profesor në Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Universiteti i Prishtinës
Anëtare e Këshillit Shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtare e ekipit editorial të konferencës.

Dr. sc. Linda Grapci-Kotorri
Professor at the Faculty of Mathematical Natural Sciences, Department of Biology, University of Prishtina
Member of the Scientific Council at the Kosovo Pedagogical Institute
Member of the conference editorial team.



Dr. sc. Naser Zabeli
Profesor i asocuar në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë
Anëtar i Këshillit Shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtar i ekipit editorial të konferencës.

Dr. sc. Naser Zabeli
Associate Professor at the Faculty of Education, University of Prishtina "Hasan Prishtina", Prishtina.
Member of the Scientific Council at the Kosovo Pedagogical Institute.
Member of Editorial Team of Conference



MA sci. Ismet Potera
PhD kandidat në Shkencat e Edukimit, në Fakultetin e Edukimit
Hulumtues për inovacione dhe studime krahasuese në Institutin Pedagogjik të Kosovës, shef i Sektorit të Hulumtimeve
Anëtar i ekipit editorial të konferencës.

MA sci Ismet Potera
Ph.D candidate in Education Sciences at the Faculty of Education.
Researcher for innovations and comparative studies; KPI, Head of Research Sector.
Member of the Editorial Team of the Conference



Mr.sc. Selim Mehmeti
MA, Menaxhim i Arsimit
Hulumtues për standarde dhe vlerësim në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtar i ekipit editorial të konferencës.

Mr.sc.Selim Mehmeti
MA, Education Management
Researcher for standards and assessment at the Kosovo Pedagogical Institute
Member of the Editorial Team and Conference Curator Team



Dr.sc. Murteza Osdautaj - Shkencat Filologjike dhe Mr.sc. në Edukim Special
Hulumtues shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtar i ekipit editorial të konferencës.

Dr.sc. Murteza Osdautaj - Philological Sciences and Mr.sc. Special Education
Scientific Researcher at the Kosovo Pedagogical Institute
Member of the Editorial Team and Conference Curator Team



Fitore Maliqi
Master i Ekonomisë
Zyrtare Financiare në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtare e ekipit organizativ të konferencës.

Fitore Maliqi
Master of Economy
Financial officer at Kosovo Pedagogical Institute
Member of organizational team of the Conference



Bekim Morina
Master i Shkencave Filologjike
Hulumtues për planifikim shkollor dhe politika arsimore në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtar i ekipit organizativ të konferencës.

Bekim Morina
Master of Philological Sciences
Researcher for school planning and educational policy at the Kosovo Pedagogical Institute.
Member of the organizational team of the Conference



Skender Mekolli
Hulumtues për arsim të përgjithshëm
Anëtar i ekipit organizativ të konferencës.

Skender Mekolli
Researcher for general education
Member of the organizational team of the Conference



PhD.C. Amantina Pervizaj Kelmendi – Language and Cognitive Neuroscience- Universiteti i Zagrebit. Moderuese dhe fasilituese e organizimit të përgjithshëm të konferencës.
Anëtare e ekipit organizativ të konferencës. Instituti Pedagogjik i Kosovës

PhD.C. Amantina Pervizaj Kelmendi - Language and Cognitive Neuroscience- University of Zagreb
Moderator and facilitator of the general organization of the conference.
Member of organizational team of the Conference
Kosovo Pedagogical Institute



Msc. Agim Bujari
Master i Pedagogjisë, Departamenti i Pedagogjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës
Hulumtues për mësimdhënie dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Anëtar i ekipit organizativ të konferencës.

Msc. Agim Bujari
Master of Pedagogy, Department of Pedagogy, Faculty of Philosophy, University of Prishtina
Researcher for teaching and professional development of teachers at the Kosovo Pedagogical Institute
Member of organizational team of the Conference

## Folësit kryesorë

Prezantimi i praktikave vendore dhe atyre ndërkombëtare në raport me ndikimet e pandemisë COVID-19 në sistemet arsimore dhe reflektimet për përvojat e mira në tejkalimin e sfidave është fokusi kryesor i kësaj konference. Folësit dhe prezantuesit në konferencë, me prezantimet e tyre, do të fokusohen në sjelljen e gjetjeve të fundit nga hulumtimet dhe praktikat e vendeve dhe institucioneve që përfaqësojnë.

## Keynote speakers

Presentation of local and international practices in relation to the impact of the impact of the COVID-19 pandemic on the education system and reflection on good experiences in overcoming challenges is the main focus of this conference. Keynote speakers and presenters at the Conference with their presentations will focus on bringing the latest findings from research and practice from the countries and institutions they represent.

# NDIKIMI I COVID-19 NË HUMBJET MËSIMORE, PASOJAT NË RRITJEN E PABARAZIVE NË MËSIM DHE SFIDAT E PËRMBUSHJES/ KOMPENSIMIT

# IMPACT OF COVID-19 ON LEARNING LOSSES, CONSEQUENCES ON INCREASING LEARNING INEQUALITIES AND FULFILLMENT / COMPENSATION CHALLENGES

**Realizuar nga:**
Hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës

**Raporti është hartuar nga:**
Selim Mehmeti, Haxhere Zylfiu, Lirije Bytyqi, Agim Bujari, Skender Mekolli, Mevlude Aliu, Bekim Morina, Ismet Potera

## Abstrakt

Objekt i këtij studimi ishte një ndër çështjet qendrore të debateve dhe kërkimeve në fushën e edukimit, siç është ndikimi i pandemisë COVID–19 në arsim. Theks i veçantë ishte ndikimi në humbjet mësimore dhe thellimin e pabarazive në arsim. Mbyllja e shkollave dhe organizimi i mësimit në distancë, për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së pandemisë globale COVID-19, rihapja e shkollave dhe organizimi i mësimit në kushte të pandemisë globale, kanë afektuar të gjitha sistemet arsimore në botë. Ndërkohë, reagimet e sistemeve arsimore ndaj rrethanave të krijuara kanë qenë të ndryshme, të cilat kanë nxitur diskutimet, shqetësimet dhe studimet lidhur me shkallën e ndikimit të pandemisë në humbjet në arsim. Qasja hulumtuese në këtë studim është e

## Abstract

The object of this study was one of the central issues of debate and research in the field of education, such as the impact of the COVID-19 pandemic on education. Particular emphasis was placed on the impact on learning losses and the deepening of inequalities in education. The closure of schools and the organization of distance learning, due to preventive measures against the spread of the global pandemic COVID-19, the reopening of schools and the organization of education in the context of the global pandemic, have affected all education systems in the world. Meanwhile, the reactions of the education systems to the created circumstances have been different, which have prompted discussions, concerns and studies regarding the degree of impact of the pandemic

përzier, sasiore dhe cilësore, me një mostër të qëllimshme nga komuniteti i 52 shkollave (n=2504 nxënës; n = 490 mësimdhënës; n= 63 drejtorë të shkollave; n=826 prindër) nga 15 komuna të Kosovës. Të dhënat janë mbledhur me anë të pyetësorëve të anketës dhe testeve të vlerësimit, me nxënësit e klasave të dyta dhe të shtata. Gjetjet nga studimi tregojnë se masat e ndërmarra nga institucionet arsimore për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë janë përqendruar më shumë në aspektet organizative të mësimit, në përgjigje rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, në kujdesin shëndetësor, pjesëmarrjen fizike të nxënësve në shkollë, realizimin e programeve mësimore, kundrejt masave dhe veprimeve për këshillim dhe mbështetje psiko-sociale për fëmijët gjatë mësimit në kushtet e pandemisë, masave për të shmangur thellimin e pabarazive arsimore dhe zvogëlimin e humbjeve mësimore. Metodologjia për vlerësimin e humbjeve mësimore, e përdorur në këtë studim, bazohet në metodologjinë e Bankës Botërore, në raportin për humbjet mësimore në periudhën e parë të pandemisë në Ballkanin Perëndimor. Tregon se ndikimi i pandemisë në humbjet mësimore të nxënësve në Kosovë është i mundshëm të jetë sipas dy skenarëve: (i) humbje mësimore të krahasuara me 41 pikë të nxënit PISA, apo mbi një vit të shkollimit, si rezultat i mospjesëmarrjes së nxënësve në mësimin në

on losses in education. The research approach in this study is mixed, quantitative and qualitative, with a deliberate sample from the community of 52 schools (n = 2504 students; n = 490 teachers; n = 63 school principals; n = 826 parents) from 15 municipalities of Kosovo. The data were collected through survey questionnaires and assessment tests, with second($2^{nd}$) and seventh($7^{th}$) grade students. Findings from the study show that the measures taken by educational institutions to organize learning in pandemic conditions are more focused on the organizational aspects of learning, in response to the circumstances created by the COVID-19 pandemic, in health care, physical participation of students in school , implementation of curricula, against measures and actions for counseling and psycho-social support for children during learning in pandemic conditions, measures to avoid deepening educational inequalities and reducing learning losses. The learning loss assessment methodology used in this study is based on the World Bank methodology, in the report on learning losses in the first period of the pandemic in the Western Balkans. Shows that the impact of the pandemic on student learning loss in Kosovo is likely to be according to two scenarios: (i) learning loss compared to 41 PISA learning points, or over one year of schooling, as

distancë, në periudhën mars-qershor 2020, kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta dhe reduktimit të kurrikulave në vitin shkollor 2020/2021; dhe (ii) humbje mësimore të krahasuara me 24 pikë të të nxënit PISA, apo më shumë se 60% e një viti të shkollimit sipas pikëve të të nxënit PISA, si rezultat i metodave të mësimdhënies joefektive gjatë mësimit në distancë dhe kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta. Humbjet mësimore dhe pabarazitë në mësim në rritje dalin në pah edhe në vlerësimet e organizuara në kuadër të këtij studimi, me nxënësit e klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe dhe nxënësit e klasës së shtatë në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë.

Ky studim ofron rekomandimet për institucionet arsimore, për qëllime të orientimit të politikave arsimore lidhur me ngritjen e sistemit pas pandemisë dhe praktikave institucionale për mbështetjen e nxënësve për zbutjen në masë të mundshme të humbjeve mësimore dhe për të eliminuar pabarazitë në mësim.

**Fjalët çelës:** *organizim i mësimit, në kushte të pandemisë, kohë mësimore e humbur, humbje mësimore, pabarazi.*

a result of student non-participation in learning at a distance, in the period March-June 2020, lost teaching time with a duration of 25-30 minutes and reduction of curricula in the school year 2020/2021; and (ii) learning losses compared to 24 PISA learning points, or more than 60% of a school year according to PISA learning points, as a result of ineffective distance learning methods and lost teaching time with duration of lessons 25-30 minutes. Learning losses and inequalities in increasing learning are also highlighted in the assessments organized within this study, with second grade students in the subject of Albanian Language and seventh grade students in the subject of Albanian Language and Mathematics.

This study provides recommendations for educational institutions, for the purposes of orienting educational policies related to the establishment of the post-pandemic system and institutional practices to support students to mitigate possible learning losses and eliminate inequalities in learning.

**Keywords**: *learning organization, in pandemic conditions, lost teaching time, learning loss, inequality.*



Prof. Ass. Dr. Blerim Saqipi është ligjërues në Fakultetin e Edukimit, nga viti 2007. Ka përfunduar doktoratën në edukim në Universitetin e Jyvaskyla-s në Finlandë, me fokus në zhvillimin e profesionalizmit të mësimdhënësve në kontekst të reformës së thellë arsimore. Studimet e nivelit master i ka përfunduar në Universitetin e Lethbridge-it në Alberta të Kanadasë në fushën e edukimit. Ligjëron kurset e fushës së metodave të hulumtimit dhe politikave arsimore. Ka qenë anëtar në mekanizma të ndryshëm brenda Universitetit të Prishtinës (Këshilli i Cilësisë në Universitet, Këshilli i Doktoratës në Fakultet) dhe në nivel të sistemit të arsimit (Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve, Këshilli Shtetëror i Maturës, Këshilli Shkencor i Institutit Pedagogjik të Kosovës etj). Nga viti 2017 është anëtar i bordit të revistës Center for Education Policy Studies (indeksuar në SCOPUS) në Universitetin e Lubjanës. Fusha e interesimit në punën kërkimore fokusohet në studimin e politikave arsimore, me theks në zhvillimin e shkollës dhe politikat e përgatitjes së mësimdhënësve dhe ndërlidhja e tyre me dimensionet profesionale dhe sociale të sistemit të arsimit.

Prof. Ass. Dr. Blerim Saqipi is lecturer at the Faculty of Education since 2007. He completed his doctorate in education at the University of Jyvaskyla in Finland with a focus on developing teacher professionalism in the context of in-depth educational reform. He completed his master's degree in education at the University of Lethbridge in Alberta, Canada. Lectures the courses in the field of research methods and educational policies. He has been a member of various mechanisms within the University of Prishtina (Quality Council at the University, Doctoral Council at the Faculty) and at the level of the education system (State Teacher Licensing Council, State Matura Council, Scientific Council of the Pedagogical Institute of Kosovo, etc.). Since 2017 he is a board member of the journal Center for Education Policy Studies (indexed in SCOPUS) at the University of Ljubljana. The field of interest in research work focuses on the study of educational policies, with emphasis on school development and teacher preparation policies and their relationship with the professional and social dimensions of the education system.

# SFIDAT E PËRGATITJES SË MËSIMDHËNËSVE TË RINJ GJATË MËSIMIT NË DISTANCË: MOTIVIMI DHE ANGAZHIMI I STUDENTËVE

# CHALENGES OF ONLINE EDUCATION IN TEACHER EDUCATION: MOTIVATION AND ENGAGEMENT OF STUDENTS

Prof. Asoc. Dr. Blerim Saqipi, Faculty of Education, University of Prishtina
Prof. Ass. Dr.Blerta Perolli Shehu, Faculty of Education, University of Prishtina

## Abstrakt

Ndërprerja e paprecedentë e jetës së përditshme dhe arsimit që i solli komunitetit tonë global si rezultat i pandemisë COVID-19, i vendosi institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, duke përfshirë arsimimin e mësuesve, në gjendje të ofrojnë mësimdhënie në distancë dhe online, pa përgatitje paraprake, trajnim apo përvojë të të mësuarit online. Arsimi online në kontekstin e Kosovës, si shtet i ri dhe demokraci dhe ekonomi në tranzicion, është një koncept relativisht i ri dhe më shumë është folur se sa është zbatuar. Ky studim kishte për synim të identifikojë faktorët që ndikojnë në motivimin e studentëve të mësuesisë për të mësuar online dhe perceptimin e tyre mbi efektet e kësaj metode në zhvillimin e tyre profesional dhe mirëqenien psikologjike në kohën e COVID-19. Duke u mbështetur në Teorinë e Vetëpërcaktimit (SDT), studimi hulumtoi konstruktet e kompetencës, autonomisë dhe lidhjes me të tjerët, pasi ato lidhen me motivimin dhe angazhimin e studentëve dhe profesorëve në mësimin online si një masë për të zbatuar kurrikulat e edukimit të mësuesve në

## Abstract

The unprecedented disruption of daily life and education brought to our global community as a result of the COVID-19 pandemic, placed higher education institutions in Kosovo, including teacher education, in a position to provide distance and online teaching, with no prior preparation, training or experience of the pedagogy of online learning. Online education in Kosovo context, as a new state and transitioning democracy and economy, is a relatively new concept and more has been talked about than implemented. This study aims to identify factors influencing the motivation of student teachers for online learning and their perception on the effects of this method on their professional development and psychological wellbeing in the age of COVID-19. Drawing on the Self Determination Theory (SDT), the study explored constructs of competence, autonomy and relatedness as they relate to motivation and engagement of student teachers and teacher educators in online learning as a measure to implement teacher education curricula under

rrethana të reja. Pjesëmarrës në studim ishin 420 studentë të edukimit dhe dhe 22 profesorë dhe asistentë në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës.

Sondazhi pasqyroi konstruktet e motivimit, angazhimit, lidhjes me të tjerët, njohurive dhe zgjidhjes së problemeve, menaxhimit të të mësuarit dhe ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e studentëve. Rezultatet fillestare tregojnë korrelacione të rëndësishme pozitive midis autonomisë, kompetencës dhe lidhjes me të tjerët me motivimin dhe angazhimin. Rezultatet tregojnë gjithashtu efektet pozitive të angazhimit me mësimin online në tejkalimin e vështirësive psikologjike me të cilat përballemi gjatë izolimit social. Gjetjet pritet të mbështesin institucionet e përgatitjes së mësuesve dhe profesorët të gjejnë mënyra për të mbështetur dhe përmirësuar motivimin dhe angazhimin e studentëve në mësimin online gjatë dhe përtej kohës së COVID-19 .

**Fjalët çelës**: *Motivimi, angazhimi, të mësuarit online, COVID-19, aftësimi i mësimdhënësve, Kosova.*

new circumstances. Participants in the study were 420 student teachers and 22 teacher educators at the University of Prishtina's Faculty of Education.

The survey reflected the constructs of motivation, engagement, relatedness with peers, knowledge and problem solving, learning management, and impact of COVID-19 on the wellbeing of students. Initial results indicate significant positive correlations between autonomy, competence and relatedness with motivation and engagement. Results also indicate positive effects of engagement with online learning in overcoming psychological difficulties faced while in social isolation. The findings are expected to support teacher education institutions and professors find ways to support and improve student motivation and engagement in online learning during and beyond the COVID-19 time.

**Key words**: *Motivation, engagement, online learning, COVID19, teacher education, Kosovo.*

## Anton Gojçaj



Anton Gojçaj lindi në Podgoricë në vitin 1966. Shkollën fillore e kreu në Tuz, të mesmen në Zarë, kurse Fakultetin Filologjik në Prishtinë. Studimet pasunivesitare po ashtu i ndoqi në Universitetin e Prishtinës, ku edhe magjistroi. Që nga viti 2008 punon në Entin e Arsimit (Zavod za školstvo) në Podgoricë, si mbikëqyrës (këshilltar pedagogjik) i lëndës mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi, për shkollat fillore dhe të mesme. Jeton në Tuz.

Anton Gojçaj was born in Podgorica in 1966.

He finished primary school in Tuz, high school in Zadar, and the Faculty of Philology in Pristina. He also attended postgraduate studies at the University of Prishtina, where he received his master's degree. Since 2008 he has been working at the Institute of Education (Zavod za školstvo) in Podgorica, as a student (pedagogical advisor) of the subject Albanian Language and Literature, for primary and secondary schools. Lives in Tuz.



## Dr. Tanja Rupnik Vec

Tanja Rupnik Vec, PhD. psychologist, supervisor and cocach is the head of the center for quality and research at the National Education Institute of Slovenia. She provides group supervision for different groups of teachers and a variety of training and counseling for schools on various psychological topics. She is the author or co-author of several scientific and professional monographs and articles in the field of critical thinking, teaching of psychology, implementing changes in schools, learning motivation, supervision and professional development, socio-emotional learning and empathy. In the last few years she coordinated slovenian activities in the two ICT international projects (EUfolio and ATS2020) and has just finished a second research report about the quality of distance learning during covid-19 in Slovenia.



## Jasna Rojc

Jasna Rojc graduated in art history and comparative linguistics. She has 23 years of work experience in secondary and higher professional education as a teacher and a principal. In addition to her school work, she has participated in many projects with various professional institutions in the field of education. Since 2019, she has been employed at the National Education Institute Slovenia as a senior consultant in the department of secondary education. Her field of activity is development of the secondary education system, the development of curricula and the professional development of teachers

# DISTANCE LEARNING DURING THE COVID-19 PANDEMIC AND SUPPORT FOR SCHOOLS IN OVERCOMING THE CHALLENGES

Dr. Tanja Rupnik Vec, Jasna Rojc
National Education Institute of Slovenia

**Abstract**

In Slovenia the schools were closed almost for three months during the first wave of covid-19 and four months during the second wave. During the school closure the education system significantly transformed from the aspect of organisation and realization of school work: schools at all levels continued their activities, but instead of classical, in-person teaching, they organized their work on-line. There were several different models of distance teaching and learning, from completely asynchronous to synchronous lessons. National Education Institute of Slovenia had an important role in this period by carrying out different activities: organising delivery of computers for pupils and students from deprived families, preparation of guidelines for development of online lessons and materials, organising seminars for teachers and networking with the aim of sharing examples of good practice and giving each other mutual support. We also made two researches about teaching and learning during the pandemic.

In the first part of this article we will show some interesting results from both researches. In the first research we focused on experiencing distance learning from the three perspectives: perspective of students (N=23078), perspective of teachers (N=7382) and perspective of principals (N=406). The focus of the research were different aspects of teaching and learning during the time of isolation. In the second research (N=22556) we narrowed the focus, researching lessons in math and Slovenian language in details through the students' perspective and some social-emotional aspects of their learning. The results gave us an important insight into the distance education in Slovenia during the covid-19 pandemic that have enabled us to provide further recommendation to teachers and principals and implement various forms of support for schools.

However, the situation caused by the pandemic has also revealed weaknesses in schools that are not necessarily the result of changes in schooling in that time. It highlighted some areas of education system that should be strengthened in order to prepare for possible new crises and, above all, to

function better in the future. Therefore, initially the general recommendations grew into concrete guidelines for further development of school work. Their aim was to reduce the consequences of the period of closed schools and improve pedagogical practices in the future. The second part of the article offers an insight into this aspect of the topic.



Z. Cristian Fabbi është President i sistemit parashkollor Reggio Emilia, në Itali. Ai ka diplomuar Bachelor në Psikologji dhe Master në Edukimin e Fëmijërisë së Hershme dhe është një psikoterapist Relacional i trajnuar profesionalisht.

Ka punuar në Njësinë e Kujdesit dhe Edukimit në Fëmijërinë e Hershme në Byronë Ndërkombëtare të Arsimit (IBE) të UNESCO-s. Ai, gjithashtu, punoi në qytetet miqësore për fëmijët në emër të UNICEF-it, duke zhvilluar kuadrin shqiptar. Aktualisht është duke punuar në çështjet e fëmijërisë së hershme, në emër të agjencive të OKB-së dhe OJQ-ve.

Është konsulent me Caritasin e Zvicrës në Kosovë që nga viti 2018, në kuadër të projektit SHPRESE për arsimin parashkollor.

Mr Cristian Fabbi is President of the Reggio Emilia preschool system, in Italy. He holds a Bachelor's Degree in Psychology, a Master's Degree in Early Childhood Education and is a professionally trained Relational Psychotherapist.

He worked on Early Childhood Care and Education Unit at the International Bureau of Education (IBE) of UNESCO. He also worked on Child-Friendly cities on behalf of UNICEF, developing the Albanian framework. He is currently working on Early Childhood matters on behalf of UN agencies and iNGOs.

He consults with Caritas Switzerland in Kosovo since 2018 within the SHPRESE project on pre-primary education.

# NOSTALGIA FOR THE FUTURE: ENVISIONING THE POST COVID-19 EARLY EDUCATION

*Cristian Fabbi, International Consultant, Caritas Switzerland in Kosovo*
Keywords: covid-19, education challenges, innovation, future of education

**Abstract**

The COVID-19 is the core topic of each area of human interaction, as it invades every dimension of our life.

More than all the other stages of education, Early Childhood has paid a very high price in terms of access, quality, and equity.

Calculations and data are disputable, but we might accept the following estimate, based on UNESCO UIS sources: 19.01 billion person-days of ECCE instruction lost, 10.75 million additional children falling “off track” in their early development, 14.18 million grades of learning lost by adolescence, and a present discounted value of USD 308.02 billions of earnings lost in adulthood (Mc Coy et al., Child Development, Vol. 5, Issue 92, 2021).

What is the heritage of this situation? What are the strategies to overcome this kind of consequence?

Many teachers and educators are searching for a way forward in developing digital tools for early education; others are heading towards the green environment and outdoor education, while others are focusing more on the emotional losses of the COVID-19 time. All of them probably have good options to offer, band at the same time none of them is the solution. One more time, the educators heading towards future early childhood care and education have to search for their way within the holistic approach, trying to mobilize more and more the different components of the society, starting from the parents.

Digital tools had (and are having) a prominent role during pandemics in order to keep education continuity.

Prior to pandemic, in ECD, technologies were used as communication rather than as a pedagogical tool. During the pandemics it has become also a pedagogical tool, used under the supervision of adults and, in certain cases, also individually (Using Digital Technologies for early Education during COVID-19, the OECD, 2020).

Sustainability has become another focus point during and after pandemics. Moreover, sustainability is nowadays a main topic of early education. It is critical to accelerate education towards a sustainable future. The challenge concerns the training of education professionals in digital culture. Teachers' education appears as the most important factor for the success of students, who must be able to adapt throughout their lives to a constantly changing environment (The effects of COVID-19 on Early Childhood Education and Care: Research and Resources for Children, Families, Teachers and Teacher Education, Jalongo, M. R., Early Childhood Education Journal, 49, 2021).

Creativity is also an important topic to discuss with early educators. Creativity is an entry point and a key capacity in uncertain times, and it is important to develop the capacity of children to reimagine the world starting from daily life and learning processes. The pandemic has shown us the importance for individuals and societies to have the ability to quickly respond to unexpected risks. This implies the ability to understand complexity, to anticipate different scenarios, to negotiate trade-offs, to be ready to act quickly based on limited information, and to collaborate in finding the best solutions (Build back better: Education must change after COVID-19 to meet the climate crisis, Giannini, S. UNESCO, 2021).

Dashurije Shaqiri ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Edukimit në Universitetin “Hasan Prishtina”, programi Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ka përvojë 23-vjeçare në arsim, si mësimdhënëse në nivelin fillor në ShFMU “Abaz Ajeti” në Gjilan. Ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme në fushën e arsimit, është trajnere e Mendimit Kritik dhe Lexim- Shkrimit dhe fasilitatore e trajnimit Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme. Ka qenë e angazhuar në cilësinë e ekspertes në MAShT për hartimin e PIA-s për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente. Po ashtu, ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare.

# SFIDAT DHE PËRKRAHJA E PRINDËRVE NDAJ FËMIJËVE NË NIVELIN FILLOR TË ARSIMIT GJATË COVID-19

# CHALLENGES AND PARENTS 'SUPPORT TO CHILDREN IN PRIMARY EDUCATION DURING COVID 19

MA. Dashurije Shaqiri
SHFMU "Abaz Ajeti" Gjilan
Email: dashurije.shaqiri@hotmail.com
Recensents: Dr. sc. Sabri Tahiri
Prof. MD. Sadri Daku

**Abstrakt**

Situata gjatë pandemisë COVID-19 ka shkaktuar probleme të ndryshme në çdo aspekt të shoqërisë, përfshirë edhe arsimin. Si në gjithë botën, edhe në vendin tonë është shtruar nevoja për të organizuar mësimin në distancë, mësim ky që u shoqërua me sfida të ndryshme, si për fëmijët ashtu edhe për prindërit.

Qëllimi i këtij studimi është të prezantojë sfidat dhe mbështetjen që i dhanë prindërit fëmijëve të tyre për përmbushjen e obligimeve në mësim gjatë COVID-19.

Metoda e hulumtimit është e përzier (statistikore dhe bashkëbisedim me fokus-grupin). Instrumente të hulumtimit ishin: pyetësori i strukturuar dhe diskutimet me fokus-grupin. Mostra e hulumtimit janë 200 prindër, 191 janë pjesë e anketimeve përmes pyetësorit dhe 9 prindër pjesëmarrës në fokus-grup. Të dhënat

**Abstract**

The situation during the COVID-19 pandemic has caused various problems in every aspect of society including education. Both in the world and in our country, there is a need to organize distance learning, a lesson that was accompanied by various challenges for both children and parents.

The purpose of this study is to present the challenges and support that parents gave to their children to meet their learning obligations during COVID 19.

The research method is mixed (statistical and conversation with the Focus Group). The research tools will be: Structured questionnaire and discussions in the Focus Group. The research sample is 200 parents, 191 are part of the questionnaire surveys and 9 parents participated in the Focus Group. Quantitative

sasiore janë përpunuar përmes programit SPSS, ndërsa ato cilësore, të regjistruara me zë, përmes analizës përmbajtjesore.

Përmes hulumtimit u jepen përgjigje pyetjeve: Sa keni arritur ta ndihmoni fëmijën tuaj në mësim gjatë pandemisë? Cilat ishin vështirësitë kryesore që kishte fëmija juaj në mësim gjatë COVID-19?

Të gjeturat e këtij studimi kanë për qëllim të nxjerrin në pah sfidat dhe mënyrat e përkrahjes së prindërve ndaj fëmijëve të tyre, përkitazi me procesin e të mësuarit gjatë kohës së pandemisë.

**Fjalët çelës**: *prind, fëmijë, përkrahje, sfidë, mësim, COVID-19.*

data will be processed through the SPSS program, while qualitative data recorded by voice are processed through content analysis.

The research will answer the questions: How much did you manage to help your child with learning during the pandemic? What were the main learning difficulties your child had during COVID 19?

The findings of this study aim to highlight the challenges and ways parents support their children in relation to the learning process during the pandemic.

**Keywords**: *parent, child, support, challenge, lesson, COVID 19*



Antigona Mehmeti, 24 vjeçare, e lindur më 01.10.1997 në Gjilan, shkollën fillore dhe gjimnazin e ka përfunduar në Gjilan, studimet universitare bachelor i kam filluar në vitin 2015 në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, në Departamentin e Biologjisë, të cilat i përfundoi në vitin 2018. Ka marrë pjesë në disa workshope të organizuara nga UNICEF-i dhe disa organizata joqeveritare në ndihmë të komunitetit në Gjilan. Në vitin 2018/2019 vazhdoi studimet master në Fakultetin e Edukimit, me drejtim Mësimdhënie lëndore me specializim në Biologji, ka përfunduar temën e diplomës dhe pret të diplomojë. Është duke punuar si zëvendësuese e biologjisë në disa shkolla të komunës së Gjilanit.

Antigona Mehmeti, 24 years old, born on 01.10.1997 in Gjilan, completed primary school and gymnasium in Gjilan, I started my bachelor university studies in 2015 at the University of Prishtina "Hasan Prishtina", at the Faculty of Mathematical and Natural Sciences , in the Department of Biology, which he completed in 2018. He has participated in several workshops organized by UNICEF and several non-governmental organizations to help the community in Gjilan. In 2018/2019 he continued his master studies at the Faculty of Education, majoring in Subject Teaching with a specialization in Biology, has completed the diploma thesis and expects to graduate. She is working as a biology substitute in some schools in the municipality of Gjilan.

# PERCEPTIMET E NXËNËSVE TË KLASËS XII PËR COVID-19 DHE NDIKIMI NË JETËN DHE TË NXËNIT E TYRE

# GRADE XII STUDENTS' PERCEPTIONS OF COVID-19 AND THE IMPACT ON THEIR LIVES AND LEARNING

**Antigona Mehmeti**

## Abstrakt

Pandemia COVID-19 ka paraqitur sfida të mëdha në gjithë botën, veçanërisht në sistemin edukativo-arsimor. Shkollat luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijëve dhe të rriturve, jo vetëm në aspektin akademik, por, gjithashtu, në anën sociale, emocionale dhe fizike. Pandemia, e cila mundësoi kalimin nga klasat ballë për ballë në klasat online, vuri në pah vështirësi nga më të ndryshmet, duke filluar nga mungesa e internetit në secilën shtëpi, vështirësitë në përdorimin e teknologjisë, sfida e arritjeve akademike të dëshiruara për nxënësit, si dhe ruajtja e shëndetit fizik e psikik. Andaj, ky hulumtim ka të bëjë me perceptimet e nxënësve rreth pandemisë dhe ndikimin që shkaktoi në jetën dhe të nxënit e tyre. Efektet që shkaktoi pandemia, si në arsimimin ashtu edhe në gjendjen emocionale të nxënësve, ndikuan në fillimin e shumë hulumtimeve.

Për të zbuluar ndikimet e kësaj pandemie në jetën e nxënësve, kemi kryer një hulumtim me gjithsej 190 respondentë, të grupmoshave 16-18

## Abstract

The COVID-19 pandemic has posed major challenges worldwide, particularly in the education system. Schools play an important role in the lives of children and adults not only academically but also socially, emotionally and physically. The pandemic, which enabled the transition from face-to-face classes to online classes, highlighted a variety of difficulties, ranging from lack of internet in each home, difficulties in using technology, the challenge of the desired academic achievement for students, and maintaining physical and mental health. Therefore, this research is concerned with students' perceptions about the pandemic and the impact it caused on their lives and learning. The effects of the pandemic on both the education and the emotional state of the students led to the beginning of much research.

To find out the impact of this pandemic on the lives of students, we conducted a survey of a total of 190 respondents in the 16-18 age group. The research was conducted in the High School

vjeç. Hulumtimi u realizua në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Asllan Elezi” në Gjilan, me nxënës të nivelit të mesëm të lartë, përkatësisht me nxënës të klasave XII. Gjatë këtij hulumtimi, kemi përdorur metodën kuantitative (sasiore), kemi hartuar pyetësorë për nxënësit, me anë të të cilëve kuptuam perceptimet e nxënësve për pandeminë COVID-19, mangësitë dhe përparësitë e mësimit në distancë (mësimi online), pritshmëritë për distancimin shoqëror, ndikimin e pandemisë në anën personale dhe atë socio-emocionale.

Rëndësia e këtij hulumtimi bazohet në atë se si nxënësit e kanë perceptuar pandeminë, si janë ballafaquar me sfidat gjatë mësimit në distancë dhe si ka ndikuar ky tranzicion në jetën personale dhe në të nxënit e tyre. Hulumtimi zbuloi ndikimin e pandemisë në shëndetin mendor, duke rezultuar në probleme psikologjike, përfshirë stresin dhe depresionin; të cilat ndikojnë negativisht edhe në aspektin edukativo-arsimor.

**Fjalët çelës**: *arsimim, COVID-19, distancë, perceptime, shëndet.*

of Medicine "Asllan Elezi" in Gjilan, with students of upper secondary level, respectively with students of XII grades. During this research we used the quantitative method, further we designed questionnaires for students, through which we understood students' perceptions of the COVID-19 pandemic; disadvantages and advantages of distance learning (online learning), expectations for social distance, the impact of the pandemic on the personal and socio-emotional side.

The importance of this research is based on how students perceived the pandemic, how they faced the challenges during distance learning and how this transition affected their personal lives and their learning. Our research revealed the impact of the pandemic on mental health, resulting in psychological problems including stress and depression; which negatively affect the educational aspect as well.

**Keywords***: education, COVID-19, distance, perceptions, halth.*



Arbnora Lladrovci - Master në Fakultetin e Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë. Së fundmi Arbnora nisi angazhimin në organizatën 'Teach for Kosova', për të shërbyer në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të përbashkëta: ngritjes së cilësisë në arsim, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë, pa dallim.

Ajo me punimet e saj ka marrë pjesë në dy konferenca ndërkombëtare dhe së fundmi edhe në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Arbnora vazhdimisht punon në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vetvetes, prandaj shpeshherë është pjesë e punëtorive dhe trajnimeve, me tematika të ndryshme.

Master in the Faculty of Education, Department of Pedagogy. Recently, Arbnora started the engagement in the organization Teach for Kosovo to serve towards the fulfillment of common goals: raising the quality of education by providing equal opportunities for all without distinction.

With her works she has participated in two international conferences and recently in the International Conference organized by the Kosovo Pedagogical Institute.

Arbnora is constantly working towards improving and raising herself, so she is often part of workshops and trainings on various topics.

# GATISHMËRIA E MËSIMDHËNËSVE KLASORË PËR PROCESIN MËSIMOR NË DISTANCË NË KOMUNËN E PRISHTINËS

# PRIMARY SCHOOL TEACHERS` READINESS FOR DISTANCE TEACHING IN THE MUNICIPALITY OF PRISTINA

Msc. Arbnora Lladrovci
arbnora.lladrovci@gmail.com
Recensente:
Prof. dr. ass. Rozafa Shala
Prof. dr. ass. Majlinda Gjelaj
Prof. dr. ass. Vjollca Ahmedi

**Abstrakt**

Zhvillimi i hovshëm shkencor, teknik e teknologjik, zgjeroi mundësitë e të nxënit, por në të njëjtën kohë i vuri mësimdhënësit përballë kërkesave të reja. Si mundësi e tillë është edhe mësimi në distancë. Qëllimi i këtij hulumtimi është të matet gatishmëria e mësimdhënësve klasorë të komunës së Prishtinës për mësimin në distancë, duke pasur për bazë sfidat në aspektin teknologjik. Pyetja e adresuar është: Në çfarë mase ndikon mosha e mësimdhënësve në gatishmërinë e tyre teknologjike për mësim në distancë? Kurse hipoteza e ngritur është: Me rritjen e moshës, zvogëlohet gatishmëria teknologjike për zbatimin e mësimit në distancë.

Natyra e këtij hulumtimi është kuantitative, metoda për përzgjedhjen e mostrës është metoda e konvenencës ose jopropabilitare,

**Abstract**

Rapid scientific and technological development has increased the opportunities for learning, but at the same time has confronted many teachers with new demands. As such is distance teaching. The purpose of this research is to measure the readiness of primary school teachers in the municipality of Pristina for distance teaching, based on the challenges in technological terms. This research addresses the question: To what extent does the age of the teachers affect their technological readiness for distance teaching? The hypothesis is: As the age increases so does the teachers` technological readiness decrease.

The nature of this research is quantitative, the sampling method is convenience sampling or non-probability sampling design, whereas the

kurse instrumenti për mbledhjen e të dhënave është pyetësori elektronik, i cili përmban pyetje demografike, pyetje që lidhen me njohuritë e respondentëve, si dhe pyetje në formë të deklaratave (shkalla Likert), ndërsa të dhënat janë analizuar përmes SPSS. Popullatën e studimit e përbëjnë mësimdhënësit klasorë të Komunës së Prishtinës (N=755), kurse mbi bazën e tabelës “Sample size table” për besueshmërinë 95% dhe margjinën e gabimit 3.5%, madhësia e mostrës është n=396.

Hulumtimi mund të ketë disa kufizime, si: Rezultatet mund të mos jenë reprezentative për gjithë vendin, por vetëm për komunën në të cilën është realizuar hulumtimi.

Ky hulumtim jep kontribut për një temë jo shumë të studiuar përgjithësisht në botë dhe veçanërisht në vendin tonë. Nga të gjeturat rezulton se hipoteza e ngritur konfirmohet, gjithashtu kuptohet se mësimdhënësit kanë mungesë të trajnimeve teknologjike në lidhje me mësimin në distancë dhe aktivitetet që i shërbejnë këtij procesi.

**Fjalët çelës:** *gatishmëri, mësimdhënës, mësim në distancë, teknologji.*

instrument for collecting data is the online questionnaire, which contains demographical questions, questions about teachers` knowledge and questions in the form of statements (Likert scale), while the data are analyzed through SPSS. The population of the study is made of primary school teachers of the municipality of Pristina (N=755), the sample size was assigned on the basis of the “Sample Size Table” for 95% confidence and 3.5% margin of error, which resulted in the sample size n=396.

The study may have the following limitation: It may not be representative for the whole country but only for the municipality where it took place.

This study contributes on a subject that is not well-studied in the world in general and in Kosovo in particular. From the findings it is understood that the certain hypothesis is confirmed, also that teachers lack technological training related to distance teaching and activities that serve to this process.

**Keywords:** *distance teaching, readiness, teachers, technology*



Unë quhem Blerta Mehmetaj. Jam lindur dhe rritur në fshatin Isniq të Deçanit. Shkollën fillore e kam përfunduar në fshatin Isniq, kurse shkollën e mesme në gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan. Studimet në bachelor i fillova në vitin 2013 dhe i përfundova në vitin 2017 në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit – Programi Fillor. Në tetor të vitit 2017 i fillova studimet master në programin Mësimdhënia dhe kurrikula dhe mbrojta temën e diplomës në korrik të vitit 2020. Nga janari i vitit 2018 kam qenë e angazhuar në mësimdhënie, duke punuar si mësuese klase në shkollat fillore “7 Marsi” dhe “Meto Bajraktari” në Prishtinë, ndërsa nga marsi i vitit 2019 vazhdoj të jap kontributin tim si mësuese në shkollën “Gjergj Fishta” në Prishtinë. Jam e angazhuar si koordinatore në organizatën joqeveritare “EDUMEN-K”, e cila merret me zhvillimin dhe hulumtimin e gjendjes së arsimit në Kosovë. Karrierën time profesionale jam duke e vazhduar me pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca të ndryshme, të cilat po i kontribuojnë zhvillimit tim profesional.

My name is Blerta Mehmetaj. I was born and raised in the village of Isniq in Deçan. I finished primary school in the village of Isniq, and high school in the gymnasium "Vëllezërit Frashëri" in Deçan. I started my Bachelor studies in 2013 and finished them in 2017 at the University of Prishtina, Faculty of Education - Primary Program. In October 2017 I started my Master studies in the Teaching and Curriculum program and defended my diploma thesis in July 2020. From January 2018 I have been engaged in teaching working as a class teacher in the primary schools "7 March" and "Meto Bajraktari" in Pristina, while from March 2019 I continue to give my contribution as a teacher in the school "Gjergj Fishta" in Prishtina. I am engaged as a coordinator in the non-governmental organization "EDUMEN-K", which deals with the development and research of the state of education in Kosovo. I am continuing my professional career by participating in various trainings and conferences, which are contributing to my professional development



Unë quhem Shkelqesa Osmanaj. Jam lindur dhe rritur në fshatin Prekallë të Istogut. Shkollën fillore e kam përfunduar në fshatin Zallq të komunës së Istogut, kurse shkollën e mesme në gjimnazin “ Haxhi Zeka “ në Istog. Studimet në bachelor i fillova në vitin 2015 dhe i përfundova në vitin 2019 në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit- Programi Fillor, me notë mesatare 9,75. Në shtator të atij viti u punësova në shkollën fillore “Ismail Qemali” në Prishtinë, si mësuese klasore. Në tetor të atij viti fillova studimet master, në programin Edukim inkluziv, dhe i përfundova këto studime me notë 9,9, duke mbrojtur temën e diplomës në tetor të vitit 2021. Karrierën time profesionale jam duke e vazhduar duke marrë pjesë në konferenca dhe trajnime të ndryshme, të cilat vetëm rrisin cilësinë e profesionit tim dhe rrisin njohuritë e mia.

My name is Shkelqesa Osmanaj. I was born and raised in the village of Prekallë in Istog. I finished primary school in the village of Zallq in the municipality of Istog, and high school in the gymnasium "Haxhi Zeka" in Istog. I started my Bachelor studies in 2015 and finished them in 2019 at the University of Prishtina, Faculty of Education – Primary EDucation Program, with an average grade of 9.75. In September of that year I was employed in the primary school "Ismail Qemali" in Prishtina as a class teacher. In October of that year I started my Master studies in the Inclusive Education program and completed these studies with a grade of 9.9 defending my diploma thesis in October 2021. I am continuing my professional career by participating in various conferences and trainings. which only enhance the quality of my profession and enhance my knowledge.



Dijellza Hasani, e lindur më 23.01.1997 në Istog. Shkollimin fillor e kreu në fshatin Rakosh, kurse shkollimin e mesëm në gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog. Tutje vazhdoi studimet universitare në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit, në programin fillor, të cilat i përfundoi me notë mesatare 9.63. Pas përfundimit të studimeve, aktualisht është e punësuar në ShFMU " Osman Rama" në fshatin Çabër, komuna e Zubin Potokut. Vijon studimet në nivelin master, në programin Pedagogji.

Dijellza Hasani born on 23.01.1997 in Istog. She completed her primary education in the village of Rakosh, and his secondary education at the "Haxhi Zeka" gymnasium in Istog. Further continued his university studies at the University of Prishtina, at the Faculty of Education, in the primary program, which he completed with a grade point average of 9.63. After completing her studies, she is currently employed at Sh.f.m.u "Osman Rama" in the village of Çabër, municipality of Zubin Potok. As well as continuing studies at the master level, in the Pedagogy program.

# PËRPARËSITË DHE MANGËSITË E TË MËSUARIT ONLINE GJATË PANDEMISË COVID-19 NË SHKOLLAT FILLORE NË KOSOVË

# ADVANTAGES AND DISADVANTAGES OF ONLINE LEARNING DURING THE COVID-19 PANDEMIC IN PRIMARY SCHOOLS IN KOSOVO

Blerta Mehmetaj,
Dijellza Haxhijaj,
Shkelqesa Osmanaj

**Abstrakti**

Pajisjet elektronike kanë ndihmuar zhvillimin e përgjithshëm të botës shoqërore, përfshirë zhvillimin dhe lehtësimin e qasjes në informacion në fushën e arsimit. Gjatë shpërthimit të pandemisë në vitin 2020, shumica e vendeve të botës vendosën një izolim total, i cili ndër të tjerash përfshinte mbylljen e institucioneve arsimore. Kjo situatë e solli sistemin arsimor para një pushimi të padëshiruar, ku nxënësit mbetën në shtëpitë e tyre. Megjithatë, për të vazhduar procesin mësimor të lënë përgjysmë, MAShT mundësoi zhvillimin e mësimit online, përmes transmetimit në programe televizive . Mësimdhënësit u udhëzuan të përdornin platforma të tilla si Zoom ose Google Meet, për të realizuar një komunikim dhe ndërveprim sinkron mes tyre.

Qëllimi i hulumtimit tone është që të vëmë në pah përparësitë dhe mangësitë e mësimit online të realizuar përmes MAShT-it dhe platformave tjera dhe të paraqesë shkallën e humbjes mësimore nga nxënësit. Gjithashtu , në bazë të

**Abstract**

Electronic devices have helped the overall development of the social world, including the development and facilitation of access to information in the field of education. During the outbreak of the pandemic in 2020, most countries of the world imposed a total isolation, which among other things included the closure of educational institutions. This situation brought the education system before an unwanted break, where students remained in their homes. However, to continue the learning process left half done, MEST enabled the development of online learning, through broadcasting on television programs. Teachers were instructed to use platforms such as Zoom or Google Meet, to realize a synchronous communication and interaction between them.

The purpose of our research is to highlight the advantages and disadvantages of online learning realized through MEST and other platforms and to present the degree of learning loss by students. Based on these results, we aim

këtyre rezultateve ne synojmë të ndikojmë vazhdimisht në përmirësimin e këtyre aspekteve , në rast që përballemi prapë me këtë situatë. Vlen të theksohet që në hulumtimin tonë merr pjesë edhe përvoja jonë personale sa i përket vështirësive tona dhe asaj që ne kemi arritur të japim te nxënësit tonë në këtë kohë pandemie.

Hulumtimi u realizua me metodën sasiore. Si instrument për mbledhjen e të dhënave u përdor pyetësori online. Mostra e studimit është metodë e thjeshtë rastësore, e cila u drejtohet të gjithë mësimdhënësve parauniversitar .

Gjetjet dhe konkluzionet e pritshme për disa nga përparësitë e të mësuarit online janë: mundësia më e ulët e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, në këtë rast COVID-19, kursimi i parave për transport për ndjekjen e procesit mësimor, qasje më e lehtë dhe më e shpejtë në procesin mësimor dhe kohë më e gjatë për vetë- studim. Kurse disa nga mangësitë e pritshme janë: mungesa e pajisjeve elektronike në shtëpitë e nxënësve, mosgatishmëria e mësimdhënësve nëpërdorimin e paisjeve teknologjike, mungesa e socializimit nxënës-nxënës, mungesa e interaktivitetit mësimdhënës-nxënës, humbje e shpejtë e përqendrimit etj.

**Fjalët çelës:** *Covid-19, mësimi në distancë, niveli i humbjes mësimore.*

to continuously influence the improvement of these aspects, in case we face this situation again. It is worth noting that our personal experience in terms of our difficulties and what we have managed to give to our students in this time of pandemic also participates in our research.

The research was conducted with the quantitative method. The online questionnaire was used as a tool for data collection. The study sample is a simple random method, which is addressed to all pre-university teachers.

The expected findings and conclusions about some of the advantages of online learning are: lower risk of spreading communicable diseases, in this case COVID-19, saving money on transportation to follow the learning process, easier and faster access to the learning process and longer time for self-study. However, some of the expected shortcomings are: lack of electronic devices in students homes, teachers unwillingness to use technological equipment, lack of student-student socialization, lack of teacher-student interactivity, rapid loss of concentration, etc.

**Keywords:** *Covid-19, distance learning, level of learning loss, online learning challenges.*

**Synohet që përmes diskutimeve në panel, me përfaqësues të institucioneve arsimore të nivelit qendror dhe lokal, si dhe kontribuuesve në fushën e arsimit, të paraqiten qëndrimet, të arriturat dhe synimet e tyre për tejkalimin e sfidave të krijuara nga pandemia COVID-19 dhe avancimin e arsimit në të ardhmen.**

**Instituti Pedagogjik i Kosovës, si kryesori në këtë proces, kontribuon në ofrimin e përvojave dhe rekomandimeve nga hulumtimet dhe praktikat vendore dhe ndërkombëtare.**

**Through panel discussions it is intended that with representatives of central and local level educational institutions and contributors in the field of education, to present their attitudes, achievements, contribution, as well as their goals for overcoming the challenges created by the COVID-19 pandemic and advancing of education in the future.**

**Kosovo Pedagogical Institute, a main actor in this process, contributes to the provision of experiences and recommendations from local and international research and practices**




## Shpresa Shala

**Shpresa Shala** lindi në Pejë, ka mbi 22 vjet përvojë pune në sektorin e arsimit.

Kontributin në fushën e arsimit e filloi nga viti 1998, si mësimdhënëse e lëndës së historisë në ShFMU "Shaban Jashari", për një vit, në qytetin e Skenderajt. Mandej, nga viti 2000 deri në vitin 2015, punoi si mësimdhënëse në ShFMU "Ibrahim Rugova" në Obiliq.

Nga viti 2015, punoi si drejtoreshë në ShFMU 'Xhemail Mustafa", në Prishtinë. Për të vazhduar kontributin dhe për të zhvilluar proceset në arsim, nga marsi i vitit 2019 vazhdoi eksperiencën e saj si drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit në komunën e Prishtinës. Angazhimi si drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit në periudhën më sfiduese të proceseve arsimore që nga paslufta, për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, bëri që drejtoresha Shpresa Shala të japë një kontribut të jashtëzakonshëm dhe shumë profesional në mbështetje të realizimit të mësimi online, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ofroi mbështetjeje të pakursyer profesionale në menaxhimin e të gjitha institucioneve edukativo-arsimore.

Shpresa Shala was born in Peja, she has over 22 years of work experience in the education sector. She started her contribution in the field of education in 1998, as a history teacher at SHFMU "Shaban Jashari" for one year in the city of Skenderaj. Then from 2000 to 2015, she worked as a teacher at SHFMU "Ibrahim Rugova" in Obiliq.

From 2015, she worked as a director at SHFMU 'Xhemail Mustafa", in Prishtina. She continued her contribution and to develop the processes in education from March 2019, she continued her experience as director of the Directorate of Education in the municipality of Prishtina.

The engagement as the director of the Directorate of Education in the most challenging period of the educational process since after the war due to the spread of the Covid-19 pandemic, made the director Shpresa Shala to give an extraordinary and very professional contribution in supporting the realization of online learning at the level central as well as local.

Also during this period he offered unstinting professional support in the management of all educational institutions.



Shahe Kameri  lindi më 10.12.1983 në Raçak - Shtime

Shkollimin – FShMN, master në Kimi Arsimore. Nga viti shkollor 2007 punon si mësimdhënëse e lëndës së Kimisë, ndërsa nga viti 2019 mban me përgjegjësi edhe detyrën e koordinatores së cilësisë në shkollën "Abdullah Shabani' në 'Carralevë.

Shahe Kameri was born on 10.12.1983 in Raçak -Shtime Education -FSHMN- Chemistry - Master -Chemistry-Education From the school year 2007  she works as a teacher of Chemistry, while from 2019 she holds with responsibility the task of KC (COORDINATOR) of the school "Abdullah Shabani" Carraleve.



Merita Berisha mori gradën e saj doktor i mjekësisë, magjistër dhe PhD nga Fakulteti i Mjekësisë (FM) i Universitetit të Prishtinës (UP). Është specializuar në Mjekësi Sociale/Shëndet Publik dhe aktualisht është profesoreshë e asociuar për Mjekësi Sociale në FM, UP. Punon në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, si drejtoreshë e Departamentit të Mjekësisë Sociale. Ofron asistencë teknike për Qeverinë e Kosovës dhe agjencitë ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të dokumenteve strategjike, hulumtimeve shëndetësore dhe ndërtimit të kapaciteteve.

Duke qenë prorektore për Cilësinë dhe zhvillimin akademik, ajo kryesoi Komitetin e Sigurimit të Cilësisë. Ajo është e certifikuar nga Kolegji Mbretëror i Obstetrikës dhe Gjinekologëve dhe është emëruar nga Ministria e Shëndetësisë e Kosovës si kryetare e Komitetit të Vlerësimit për Udhërrëfyesit dhe Protokollet Klinike.

Përvojë në koordinimin e projekteve kërkimore si EPHO, STEPs, GYTS, BI dhe punë në ndërtimin e kapaciteteve në fushën e shkathtësive të mësimdhënies, trajnimit të bashkëmoshatëve, mbikëqyrjes, mentorimit dhe vlerësimit në fushën e shëndetit dhe arsimit.

Aktualisht, është anëtare e Task-Forcës për organizimin dhe monitorimin e procesit mësimor në rrethanat e pandemisë COVID-19 në MAShTI.

Dr. Berisha jeton në Prishtinë me familjen e saj.

Merita Berisha, received her MD, master and PhD degree from University of Prishtina (UP) Medical Faculty (MF). She specialized in Social Medicine/Public Health and currently is associate professor for Social Medicine at the MF,UP. She works at the National Institute of Public Health of Kosova as a Director of the Department of Social Medicine.

She provides technical assistance to the Kosovo Government and international agencies in the area of development of strategic documents, health research and capacity building.

Being a Vice-Rector for Quality and academic development, she chaired the Quality Assurance Committee. She is certified from the Royal College of Obstetrics and Gynecologists, and is appointed from the Ministry of Health of Kosova as Head of the Evaluation Committee for Clinical Guidelines and Protocols. Experience in coordinating research projects such as EPHO, STEPs, GYTS, BI and work in capacity building in the field of teaching skills, peer to peer, supervision, mentoring and evaluation in the field of health and education.

Actually she is a member of the Task force organizing and monitoring of teaching process under the circumstances of COVID-19 pandemic at MESTI.

Dr. Berisha lives in Prishtina with her family.



## Jeton DEMI

I lindur më 1 shtator 1978 në Kamenicë, Kosovë, i kreu studimet në vitin 2005 në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Ekonomisë, Dega "Administrim Biznesi. Pas një karriere profesionale në fushën e marrëdhënieve me publik në ndërmarrje të ndryshme në Kosovë, prej gushtit 2010 drejton Zyrën e Marrëdhënieve me Publik në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Në Këshillin e Prindërve dhe Këshillin Drejtues të Shkollës në Prishtinë është angazhuar prej vitit 2015, ndërsa prej vitit 2019 është kryetar i Këshillit të Prindërve të Prishtinës.

Born on September 1, 1978 in Kamenica, Kosovo, he completed his studies in 2005 at the University of Tirana, Faculty of Economics, Department "Business Administration. After a professional career in the field of public relations in various companies in Kosovo, since August 2010 he leads the Public Relations Office at the Kosovo Pension Savings Fund. He has been engaged in the parents 'council and the governing council of the school in Prishtina since 2015, while since 2019 he has been the Chairman of the Parents' Council of Prishtina



Valdet Plakolli - psikolog shkollor

Valdet Plakolli ka përfunduar studimet themelore për psikologji në Fakultetin Filozofik - Prishtinë, Departamenti i Psikologjisë, (2005-2008), dhe studimet master shkencor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Psikologjisë, drejtimi Shkollor Organizacional, (2010-2012). Ka përfunduar trajnimin në Online Therapy Institute/Online Coach Institute – United Kingdom, ku është certifikuar Specialist Certificate in Online Therapy, diplomë me njohje ndërkombëtare (janar –shtator 2013). Trajnimet në fushën e Ndërmjetësimit në mes bashkëmoshatarëve, (tetor 2015 - dhjetor 2016 - Forum ZFD dhe KEC), ku është i certifikuar në nivelin trajner për trajner në fushën e Ndërmjetësimit në mes bashkëmoshatarëve. Trajner për "Punën me nxënës me vështirësi specifike në të nxënë", dhe për "Të drejtat e fëmijëve", certifikuar nga ekspertë - Fakulteti i Pedagogjisë në Lubjanë, Slloveni. Dhjetëra trajnime në fusha të ndryshme të psikologjisë.

Që nga viti 2008 punon psikolog shkolle, në një shkollë fillore të mesme të ulët. Puna e tij është e përkushtuar në ruajtjen dhe mirëqenien e shëndetit mendor të nxënësve, prindërve, personelit arsimor dhe në hulumtime të fenomeneve shoqërore që janë të lidhura me shkollën. Testimin e moshës së nxënësve, vështirësitë në të nxënë, sjelljet asociale, delikuencën etj. Anëtar (për 5 vjet) i ekipit komunal për identifikimin dhe trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Valdet Plakolli has completed basic studies in psychology at the Faculty of Philosophy - Prishtina, Department of Psychology, (2005-2008), and Master of Science studies at the University of Tirana, Faculty of Social Sciences, Department of Psychology, Organizational School direction, (2010-2012). He completed the training at the Online Therapy Institute / Online Coach Institute - the United Kingdom, where he was certified Specialist Certificate in Online Therapy, diploma with international recognition (January-September 2013). Training in

the field of Peer Mediation (October 2015 - December 2016 - Forum ZFD and KEC), where he is certified at the level of Trainer for a trainer in the field of Peer Mediation. Trainer for "Working with students with specific learning difficulties", and for "Children's Rights", certified by experts - Faculty of Pedagogy in Ljubljana, Slovenia. Dozens of training in various fields of psychology.

Since 2008 he has been working as a school psychologist, in a primary and lower secondary school, where his work is dedicated to the preservation and well-being of the mental health of students, parents, educational staff, and in research of social phenomena that are related to school.

Testing the age of students, learning difficulties, antisocial behaviors, delinquency, etc.

Member (for 5 years) of the municipal team for the identification and treatment of children with special needs.



## Enis Kelmendi

Enis Kelmendi ka lindur më 17.01.1982 në Mitrovicë.

Shkollimin e lartë dhe specializimin i ka të përfunduara në histori.

Ka punuar si mësimdhënës i historisë në shkollat e Mitrovicës, nga viti 2004 deri në 2014.

Nga viti 2014 e deri më sot ushtron funksionin e drejtorit në ShFMU “Bedri Gjinaj” në Mitrovicë.

My name is Enis Kelmendi, I was born on January 17, 1982 in Mitrovica.

I have completed higher education and specialization in history.

I worked from 2004 to 2014 as a history teacher in schools in Mitrovica.

From 2014 until today I exercise the function of director in SHFMU "Bedri Gjinaj" -Mitrovica.

**Botues**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Tirazhi:** 250 copë

**Shtypi**

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë